



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	14.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIDMSHUK	7493/2023		1/5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1306/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1306/2023 të datës 19.10.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] nga Prishtina, kundër Vendimit me Nr. Ref: 324/2023 të datës 22.09.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.12.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1306/2023 e datës 19.10.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]**
- II. Anulohet Vendimi me Nr. Ref: 324/2023 i datës 22.09.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuses "Vërejtje me shkrim".**
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunëses civil [redacted] masën disiplinore "vërejtje me shkrim" e shqiptuar sipas vendimit të anuluar si në pikën II të diapozitivit.**
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**



## A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datën 22.09.2023 ka nxjerr vendimin me numër 324/2023 me të cilin nëpunëses civile [redacted] me pozitë "Drejtores në Departamentin për Diplomaci Ekonomike" i ka shqiptuar vërejtjen me shkrim, me arsyetim tejkallim i hierarkisë.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me Nr.Ref.324/2023 të datës 22.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 19.10.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 6607/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se vërejtja e shqiptuar nga ana e Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm nuk ka mbështetje ligjore dhe po ashtu nuk është e paraprirë nga asnjë paralajmërim as me gojë e as me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.10.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 31.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit, me datë 01.12.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokollit:7199/2023, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1306/2023 të datës 19.10.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 19.10.2023 me numër protokollit 6607/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me numër të referencës Nr.Ref.324/2023 të datës 22.09.2023; Procesverbalin e datës 22.09.2023; Emalin e datës 27.04.2023 të E.Pireva drejtuar A.Rizvanolli; Emalin e datës 20.01.2023 të E.Pireva drejtuar A.Nagavci; emalin e datës 007.07.2023 të [redacted] datës 05.07.2023 të Z. Shala drejtuar E.Pireva; Emalin e datës 04.07.2023 të E.Pireva drejtuar Z.Shala; Emalin e datës 2206.2023 të E.Pireva drejtuar Z.Shala; emalin e datës 01.06.2023 të E.Pireva drejtuar Z. Shala; Emalin e datës 07.06.2023 të [redacted] drejtuar Z. Shala; Emalin e datës 07.06.2023 të A.Iberhysaj drejtuar B. Isma; Emalin e datës 21.06.2023 të [redacted] drejtuar Z. Shala; Emalin e datës 03.07.2023 të [redacted] drejtuar Z.shala; Emalin e datës 21.06.2023 të E.Pireva drejtuar F.Dyla; Emalin e datës 19.01.2023 të [redacted] drejtuar F.Dyla; Emalin e datës 21.02.2023 të E.Pireva drejtuar L.Shabani; Emalin e datës 20.01.2023 të E.Pireva drejtuar R. Bllaca; Emalin e datës 03.11.2022 të E.Pireva drejtuar R.Bllaca; Emalin e datës 02.11.2022 të R. Bllaca drejtuar [redacted] Emalin e datës 02.11.2022 të E.Pireva drejtuar R.Bllaca; Emalin e datës 02.11.2022 të drejtuar R. Bllaca; Emalin e datës 07.11.2022 të [redacted] drejtuar R. Bllaca; emalin e datës 20.01.2023 të [redacted] drejtuar R.Bllaca; Emalin e datës 22.03.2023 të [redacted] drejtuar R. Bllaca; Emalin e datës 17.03.2023 të [redacted] drejtuar R. Bllaca; Emalin e datës 17.03.2023 të E.Pireva drejtuar R. Bllaca; Emalin e datës 22.08.2023 të [redacted] drejtuar D. Latifi; Emalin e datës 22.08.2023 të Xh. Hamiti drejtuar M. Mahmuti; Emalin e datës 24.07.2023 të Xh. Hamiti drejtuar [redacted]



R. Hajdari; Emalin e datës 22.08.2023 të E.Pireva drejtuar D.Latifaj; Emalin e datës 03.07.2023 të drejtuar Z. Shala; Emalin e datës 22.08.2023 të drejtuar D.Latifaj; Emalin e datës 22.08.2023 të M. Mahmuti drejtuar Emalin e datës 22.08.2023 të Xh. Hamiti drejtuar M. Mahmuti; Emalin e datës 22.08.2022 të B. Isma drejtuar Emalin e datës 22.08.2023 të E.Pireva drejtuar L. Gashi; Emalin e datës 18.01.2022 të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar nëpunësve civil të MPJD-se; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 31.10.2023; Akt emërimin me numër 2089 të datës 13.06.2022; Përshkrimin e detyrave të punës; Emalin e datës 08.11.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pubazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në provat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimin me numër AE.Nr.52/2022 të datës 13.06.2022 ka konstatuar se ankuesja ushtron pozitën "Drejtore dhe Departamentit për Diplomaci Ekonomike" në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndaj të njëjtës Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në cilësi të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë përmes Vendimit me numër protokollit 4239 të datës 22.09.2023 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me shkrim", me arsyetim se e njëjta me datë 03.07.2023 dhe 22.08.2023 ka tejkaluar çdo hierarki të komunikimit dhe raportimit pa aranzhim paraprak, respektivisht ka kërkuar takime me Ministren e Ministrisë së Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësës dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës pretendon se "Vërejtja" e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka mbështetje ligjore, dhe po ashtu nuk është e paraprirë nga asnjë paralajmërim as me gojë e as me shkrim.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Neni 45 ka përcaktuar se: "... Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", neni 46 ka përcaktuar se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. Neni 47 ka përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", neni 48 ka përcaktuar se: 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi drejtpërdrejtë..." dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mund t'i shqiptohet masë disiplinore, mirëpo vetëm në rastet kur i njëjti konsumon në mënyrë kumulative elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë për t'iu shqiptuar masa disiplinore varësisht nga shkalla e fajësisë apo dëmi i shkaktuar.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe dëshmimeve të ofruara në lëndë nga ana e ankueses si dhe përgjigjen e datës 31.10.2023 të dërguar nga organi i punësimit konstaton se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me rastin e shqiptimit të "Vërejtjes me shkrim" për ankuesen nuk ka arritur të vërtetojë drejtë gjendjen faktike, sepse në asnjë shkresë të lëndës nuk është vërtetuar se ankuesja i ka dërguar emalin zyrtar Ministres apo Sekretarit të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ku Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës respektivisht udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankueses nuk ka qene i njoftuar gjegjësisht nuk ka qene i vendosur në C.C, kjo vërtetohet edhe në baze të përgjigjes në ankesës të dërguar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ku si prove kanë dorëzuar emalin e datës 22.08.2023 dhe emalin e datës 03.07.2023 përmes të cilës shihet qartë se ankuesja me rastin e dërgimit të emalit të datës 03.07.2023 drejtuar Asistentes Ekzekutive të Ministres në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë z, D. Latifaj, në të dy emalit e ka njoftuar respektivisht e ka vendosur në C.C Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, po ashtu Kolegji konstaton se ankuesja nuk ka pasur asnjë sjellje të parregullt ndaj mbikëqyrësit të tij të drejtpërdrejtë e as nuk ka bërë asnjë veprim jo ligjor ndaj mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, rrjedhimisht sipas kësaj ankuesje nuk ka bërë shkelje disiplinore sepse me e-malet e dërguara e njëjta përveç që e ka vendosur CC mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë ajo ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saj që i ka në baze të përkrahimit të vendit të punës, gjegjësisht mbajtjes së lidhjeve dhe bashkëpunimit me zyrtaret e lartë të Ministrive në të gjithë Qeverinë dhe institucioneve tjera me qëllim që të përcaktojë dhe zgjidh problemet dhe sigurojë funksionimin e efektshëm të departamentit në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e departamentit dhe institucionit në përgjithësi.

Andaj Kolegji konstaton se të gjitha pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara, gjegjësisht Zëvendësi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në arsyetimin e masës së shqiptuar disiplinore iu ka referuar pasojës së shkeljes, mirëpo në asnjë rrethanë nuk ka arritur të konstatojë se cili ishte dëmi apo pasoja për shkeljen e supozuar, si dhe nuk ka arritur të konstatojë lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, përkundër faktit sikurse u konstatua si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme ka qenë i njoftuar respektivisht ka qene i vendosur në C.C, në emailat zyrtare që ankuesja i ka dërguar nga në adresat zyrtare të Asistentes së Ministres apo Sekretarit të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, madje një konstatim të tillë nuk ka arritur ta konkretizojë as në arsyetimin e masës së shqiptuar se ankuesja me datë 03.07.2023 dhe 22.08.2023 të ketë kërkuar takime më Ministrin apo Sekretarin e Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pa e njoftuar apo vendosur në C.C Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e që në rrethanat e rastit konkret konstatimet duhet të jenë të faktuara me prova materiale.

Si përfundim Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi "1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i



*shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material” dhe si i tillë Vendimi me Nr. Ref: 324/2023 i datës 22.09.2023 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është akt administrativ i paligjshëm dhe si i tillë është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ngase deri tek shqiptimi i masës përmes aktit të kontestuar ka ardhur si rezultat i interpretimit apo zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit material, dhe konstatimet jo të drejtë të gjendjes faktike.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

*Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1306/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

*[Signature]*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.